



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

---

## **PROPOZIM**

### **RREGULLORE PËR VENDOSJEN, NDËRTIMIN DHE LARGIMIN E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME NË PRONËN PUBLIKE**

2022

Në mbështetje të nenit 58 pika h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr. 110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës, propozon:

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 pika c, nenit 14 paragrafi 1 dhe nenit 40 paragrafi 2 pika a) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr. 110-78095 i datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_ 2022 miraton këtë:

## PROPOZIM

### **RREGULLORE PËR VENDOSJEN, NDËRTIMIN DHE LARGIMIN E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME NË PRONËN PUBLIKE**

#### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1 Objekti i rregullimit**

1. Me këtë Rregullore përcaktohen llojet e objekteve të përkohshme, dhënia e tokës në shfrytëzim në të cilin vendosen objektet e përkohshme, kushtet dhe procedurat për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike, në të cilën Komuna ka të drejtën e administrimit deri në zbatimin e dokumenteve planore në nivelin lokal.

2. Me këtë Rregullore përcaktohet edhe Plani për vendosjen e objekteve të përkohshme.

##### **Neni 2 Vendosja e objekteve të përkohshme**

1. Vendosja dhe ndërtimi i objekteve të përkohshme sipas kësaj Rregulloreje, nënkupton të gjitha punët me karakter të përkohshëm, zhvillimin e punimeve për vendosjen/ndërtimin e bazës për vendosjen e objekteve të përkohshme dhe lidhjen e tyre në objektet e infrastrukturës publike.

1.1. Objektet e karakterit të përkohshëm mund të vendosen dhe ndërtohen në pronën publike, me kusht që:

- 1.1.1. të mos pengojnë trafikun dhe këmbësorët, funksionimin e institucioneve, bizneseve që veprimtarinë e ushtrojnë në objekte të karakterit të përhershëm si dhe nuk rrezikojnë ambientin jetësor (zhurma, largimi i mbetjeve të mbeturinave etj.);
- 1.1.2. të vendosen në pronën publike komunale;
- 1.1.3. me vendosjen e përkohshme të objekteve, nuk do të krijohen pengesa në lëvizjen e lirë në trotuare dhe në hapësira tjera;
- 1.1.4. në udhëkryqe dhe në kënde të rrugëve, të mos zvogëlohet dukshmëria dhe të mos rrezikohet siguria në komunikacion;
- 1.1.5. të mos dëmtohet vlera mjedisore dhe kulturore-historike;
- 1.1.6. objekti i vendosur të bëhet sipas terësisë së kompleksit arkitektonik;
- 1.1.7. vendosja e objektit të bëhet në distancë nga rrugët e kategorizuara, të parapara me Ligjin në fuqi për rrugët;
- 1.1.8. objekti i vendosur të mos pengojë shfrytëzimin normal të objekteve të përhershme;

- 1.1.9. objekti t'i plotësojë të gjitha kushtet estetike, funksionale dhe teknike për zhvillimin e veprimtarisë të cilat parashihen me rregulla standarde për këtë lloj të objekteve.

### **Neni 3**

#### **Kufizimet në vendosjen e objekteve të përkohshme**

**1. Objektet e përkohshme nuk mund të vendosen:**

- 1.1. Në hapësirën e cila është e mbrojtur si trashëgimi kulturore, përveç me miratimin e autoriteteve kompetente;
- 1.2. Në parqe të rregulluara dhe hapësira të gjelbërta;
- 1.3. Në pjesët hyrëse të objekteve të banimit dhe komerciale përveç në funksion të tyre;
- 1.4. Në trotuare ose në afërsi të udhëkryqeve;
- 1.5. Në pjesët aktive të ndërtesës, përveç terasave hoteliere;
- 1.6. Në hapësirat të cilat i përkasin institucioneve publike si shkollave, shtëpive të shëndetit, komunës etj.

## **II. LLOJET E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME**

### **Neni 4**

#### **Llojet e objekteve të përkohshme**

**1. Objekte të përkohshme në kuptim të kësaj Rregulloreje, konsiderohen:**

- 1.1. Pajisjet reklamuese dhe informuese;
- 1.2. Kiosqet;
- 1.3. Objektet e përkohshme montuese;
- 1.4. Paisjet lëvizëse;
- 1.5. Terasat hoteliere;
- 1.6. Strehët e udhëtarëve për pritje të autobusëve;
- 1.7. Pajisjet për lojëra fëmijësh;
- 1.8. Kabinat telefonike;
- 1.9. Gjermimi, shtrirja e rrjetit kabllor dhe shfrytëzimi i tubave nëntokësor për vendosjen e rrjetit kabllor, elektrik, internet, telefonik etj;
- 1.10. Përmendoret, pllakat përkujtimore, skulpturat dhe paisje të ngjajshme;
- 1.11. Paisje tjera të ngjajshme dhe objekte montuese të cilat sipas kushteve të kësaj Rregulloreje kanë karakterin e objekteve të përkohshme;
- 1.12. Antenat satelitore dhe transmetuese.

### **Neni 5**

#### **Pajisjet informuese dhe reklamuese**

1. Pajisjet - Panot informuese janë objekte me të cilat shoqëritë biznesore ose subjektet tjera të ndryshme ekspozojnë pllakate, reklama, njoftime etj, me qëllim të informimit të publikut për zhvillimin e manifestimeve të ndryshme kulturore, argëtuese, sportive, aktivitete performuese, politike dhe të ngjajshme si dhe pllakatet mortore dhe njoftime tjera të ngjashme.

**2. Pajisjet - Pano reklamuese konsiderohen:**

- 2.1. objektet ku subjektet e biznesit vendosin tabela reklamuese para objektit afarist me

- qëllim të reklamimit të atij biznesi;
- 2.2. objektet e kompanive, personave tjerë juridik dhe sipërmarrësit e regjistruar për kryerjen e aktiviteteve të reklamave apo marketing, të cilat për qëllime komerciale reklamojnë veprimtaritë, produktet dhe shërbimet e palëve të treta (llojet e panove reklamuese: billbordat, pano etj);
  - 2.3. pano reklamuese të cilat vendosen në fasadat dhe kulmet e ndërtesave, duke përfshirë muralet, panot, raklamat – ekrane elektronike në të cilën kompanitë, subjektet dhe sipërmarrësit e tjerë promovojnë aktivitete për nevojat e tyre apo ku organizatat e biznesit, personat e tjerë juridikë dhe sipërmarrësit e regjistruar për kryerjen e aktiviteteve të reklamave ose marketingut, produkteve dhe shërbimeve të palëve të treta ose të sigurojë një informacion apo shërbim.

## **Neni 6**

### **Kiosqet**

Kiosqet – janë objekte të përkohshme të punuara nga materiali i lehtë, me sipërfaqe max.6m<sup>2</sup> dhe lartësi deri në 2.5m, ku shiten gazeta, revista, libra, bizhuteri, suvenire, lule e të ngjashme të cilat vendosen në bazën adekuate (pllakë, beton, guri e të ngjashme) në lokacionin e paraparë me planin për vendosjen e objekteve të përkohshme.

## **Neni 7**

### **Objektet e përkohshme montuese**

Objektet e përkohshme montuese janë lokalet e përkohëshme, lokale për kryerjen e shërbimeve ekonomike (shitjet me pakicë) të cilat nuk mund të kenë sipërfaqe më të madhe se 30 m<sup>2</sup> dhe lartësi nga 2.5 m deri në 3.5 m dhe të cilat nuk mund të vendosen para objektit afarist.

## **Neni 8**

### **Paisjet lëvizëse**

1. Paisjet lëvizëse në kuptim të kësaj Rregulloreje konsiderohen: objektet të cilat mund të zhvendosen nga njëri vend në tjetrin si në vijim:

- 1.1. Vitrinat, raftet reklamuese, shtandet;
- 1.2. Tavolinat para lokaleve gjatë sezonit veror, objekt i punuar nga materiali i lehtë (druri, metali, plastika) si dhe hapsirat që shërbejnë për shitjen e mallit në funksion të objektit afarist;
- 1.3. Tavolinat lëvizëse për shitjen e librave dhe publikimeve të tjera, panoramave, fotografive artistike, bizhuterive, gjërave dekorative (luleve, kartolinave etj), mjeteve piroteknike, CD – kasetave, objekt lëvizës, të punuar nga materiali i lehtë (druri, metali ose plastika), që mund të ketë sipërfaqe deri në 3m<sup>2</sup> dhe shërben për shitjen e librave, kartolinave, panoramave, fotografive, bizhuterive;
- 1.4. Pajisjet për shitjen duhanit, pijeve freskuese, akullloreve, deserteve, pofkave, misrit, gështenjave, kikirikave dhe të ngjashme;
- 1.5. Aparat për përgatitjen e produkteve ushqimore, i cili së bashku me shtëpizën e aparatit, nuk kalon sipërfaqen prej 3m<sup>2</sup>;
- 1.6. Automjetet lëvizëse për shitjen e ushqimit të shpejtë, automjet i veçantë i atestuar për kryerjen e veprimtarisë për shitjen e ushqimit të shpejtë;
- 1.7. Tendat e hapura lëvizëse, me mekanizëm dhe me elemente montuese nga materiali pleksiglas, konstruksion, i cili vendoset mbi vitrinën reklamuese në fasadë të ndërtesës, me konstruksion të ngjitur;
- 1.8. Lojërat sezonale në parqe, grumbullim i elementeve konstruktive të mjeteve – aparateve, të cilat vendosen në një hapësirë në pronën publike të dedikuar për karakter zbavitës;

- 1.9. Panairet, promocionet, ekspozitat me produkte të ndryshme të shoqërive biznesore, etj ku mund të lidhen edhe marrëveshje e të bëhen porosi, të cilat mund të zgjasë deri në 3 ditë;
- 1.10. Shkallët para lokaleve ekzistuese dhe montuese, në bazë të lejes së dhënë nga DPUMM;
- 1.11. Gjeneratorët statikë;
- 1.12. Oxhakët e lokaleve;
- 1.13. Objektet për shërbime ambulantore, hoteliere, dhe të tjera të cilat e kanë karakterin e objekteve të përkohëshme sipas kësaj Rregulloreje.

## **Neni 9**

### **Terasat hoteliere**

1. Terasat hoteliere janë objekte që vendosen gjatë sezonit veror/dimëror me ose pa rrethojë nga xhami, nga kuota 0.00 deri në 1.7m, hapësirë që gjendet pranë apo para objektit hotelier, me pjesë të mobiluara (tavolina, karrige, çadra dhe të ngjashme) e dedikuar për ofrimin e shërbimeve në funksion të objektit hotelier në sipërfaqe të hapur.
2. Paisje të terasave hoteliere konsiderohen:
  - 2.1. Tavinat, ulëset, ombrellat dhe tendat për mbrojtje nga dielli;
  - 2.2. Vazot me lule ose gjelbrim të cilat duhet të jenë me dimensione të vogla dhe që vendosen si dekorim ose paravan nga sipërfaqet rrugore;
  - 2.3. Terasë hoteliere e cila vendoset në kohën prej 1 prill deri në 30 nëntor të vitit aktual;
3. Vendosja e terasave hoteliere lejohet në sipërfaqe të pllakëzuar ose të asfaltuar.
4. Në sipërfaqet e terasave hoteliere nuk lejohet të vendosen tepisonat, tepih, bazë rrafshuese, shtangimi i ulëseve dhe tavolinave në bazë etj.
5. Terasa hoteliere mund të vendosët me kusht që të mos pengohen hyrjet në objekte, objekte të infrastrukturës komunale dhe të mos pengohet shtegu për këmbësorë.
6. Terasat mund të zgjerohen në pjesën e sipërfaqes e cila kufizohet me fasadën joaktive të ndërtesës ose ndërtesës fqinje, ashtu që pjesa e zgjeruar nuk mund të jetë më e madhe se sa sipërfaqja para lokalit hotelier.
7. Nëse hapësira publike është e pa rregulluar për vendosjen e terasave hoteliere është e nevojshme të rregullohet sipërfaqja e parterit të terasës hoteliere.
8. Në sipërfaqet jo të rrafshta për vendosjen e terasave hoteliere lejohet që të vendosen bazat në lartësi - nivelim me dyshtet ekzistuese.
9. Në terasat hoteliere mund të vendosen trupat ngrohës me kusht që me vendosjen e tyre mos të ndikojnë në sigurinë e shfrytëzimit të terasës.
10. Nuk lejohet mbyllja e pjesëve anësore të terasave. Mbyllja e pjesëve anësore të terasës konsiderohet si rikonstruim dhe trajtohet sipas kushteve me Ligjin për Ndërtim.

## **Neni 10**

### **Strehët e udhëtarëve për pritje të autobusëve**

1. Mbulesat në transportin publik mund të jenë tipike dhe në formë modulare.

2. Mbulesat e trafikut publik përmbajnë emërimin, shenjat e linjave të autobusëve të cilat definojnë trasetë, skema e linjave urbane dhe oraret, ulëset, shporta për mbeturina dhe varësisht nga disponueshmëria e hapësirës edhe ndriqimin përkatës.

3. Baza për vendosjen e mbulesave duhet të rregullohet ashtu që të mos ndikoj në barrierë arkitektonike dhe që nuk pengon komunikimin e këmbësorëve.

#### **Neni 11**

##### **Pajisjet e lodrave për fëmijë**

1. Paisjet e lodrave për fëmijë nënkuptohen luhajat, shkallët, topoganët, trenat lëvizës e të ngjashme;

2. Në kuadër të hapësirës së dedikuar për vendosjen e paisjeve të lartëcekura si objekte të përkohëshme nënkuptohen edhe ulëset për pushim, shportat për mbeturina, fontana, hapësira, rërë, kroje për ujë etj.

#### **Neni 12**

##### **Kabinat telefonike**

Kabinat telefonike janë objekte të konstruktura nga xhami, metali dhe të ngjashme që shërbejnë për ofrimin e shërbimeve telefonike.

#### **Neni 13**

##### **Objektet për nevojat e rrjetit kabllor**

Objektet për nevojat e rrjetit kabllor në kuptim të kësaj Rregulloreje konsiderohen: Gërmimi, shtrirja e rrjetit kabllor dhe shfrytëzimi i tubave nëntokësor për vendosjen e rrjetit kabllor elektrik, internet, telefonik dhe të ngjashme.

#### **Neni 14**

##### **Përmendoret, pllakat përkujtimore, skulpturat dhe të ngjashme**

Përmendoret, pllakat përkujtimore, skulpturat dhe paisjet tjera të karakterit memorial dhe artistik, mund të vendosen në hapësirat e caktuara ose të largohen me Vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës pas propozimit të organeve kompetente të urbanizmit dhe të kulturës.

#### **Neni 15**

##### **Antenat satelitore dhe transmetuese**

Antenat satelitore dhe transmetuese janë objekte që vendosen me qëllim të emetimit të valëve të mjeteve të teknologjisë informative.

### **III. DHËNIA E TOKËS NË SHFRYTËZIM NË TË CILEN VENDOSËN OBJEKTET E PËRKOHSHME**

#### **Neni 16**

##### **Dhënia në shfrytëzim e pronës publike**

1. Për vendosjen e objekteve të përkohshme, toka në pronësi të Komunës ipet në shfrytëzim në kohë të caktuar në pajtim me Ligjin për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, akteve nënligjore në fuqi, me këtë Rregullore dhe Planin për vendosje të objekteve të përkohshme për një kohë të caktuar.

2. Dhënia në shfrytëzim e pronës publike për objektet e cekura në nenin 5 paragrafi 2.2, nenin 6 dhe 7 të kësaj Rregullore bëhet përmes ankandit publik.

3. Kontratën për shfrytëzimin e pronës publike të fituar nga ankandi publik e nënshkruan shfrytëzuesi i pronës publike, kurse në emër të Komunës Kryetari i Komunës ndërsa çështjet administrative teknike i kryen Sektori për çështje pronësoro-juridike.

#### **IV. PLANI PËR VENDOSJEN E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME**

##### **Neni 17**

##### **Plani për vendosjen e objekteve të përkohshme**

1. Objektet e përkohshme nga neni 4 i kësaj Rregulloreje vendosen në lokacionet të cilat parashihen me Planin për vendosjen e objekteve të përkohshme (në tekstin e mëtejme Plani).

2. Plani hartohet për territorin e Komunës së Lipjanit, zonat e përfshira brenda kufijëve ndërtimor të vendbanimeve të definuara me planet urbane komunale, pronat në të cilat Komuna ka të drejtën e administrimit.

3. Plani mund të hartohet me faza që nënkupton definimin e zonave urbane dhe rurale.

4. Me Planin për vendosjen e objekteve duhet të respektohet destinimi i zonave sipas Hartës Zonale të Komunës dhe objektet e përkohshme të planifikohen sipas qëllimeve të zonës.

5. Plani përmban pjesën tekstuale dhe grafike.

6. Pjesa tekstuale e Planit përmban kushtet e përgjithshme urbanistike teknike të vendosjes së objekteve të përkohshme në kuptim të llojit, tipit, sipërfaqes dhe pamjes së objekteve të përkohshme sipas zonave si dhe afatin për të cilin miratohen (ipet leja e vendosjes së tyre).

7. Pjesa Grafike e Planit prezanton përpunimin detal për secilin lokacion me kushtet urbanistike - teknike dhe i njëjti në zonat në të cilat Komuna e Lipjanit ka të drejtën e administrimit dhe definimin e zonave në të cilat do të vendosen objektet.

8. Plani për vendosjen e objekteve të përkohshme, ndryshimet dhe plotësimet e tij miratohen nga Kuvendi i Komunës për periudhën pesë (5) vjeçare.

9. Kryetari i Komunës me vendim formon grupin punues për hartimin e Planit për vendosjen e objekteve të përkohshme ose mund t'iu besohet edhe Kompanive tjera profesionale sipas Ligjit për Prokurim publik në bazë të detyrës projektuese që e harton drejtorati për çështje të urbanizmit.

#### **V. KUSHTET DHE PROCEDURAT PËR VENDOSJEN, NDËRTIMIN DHE LARGIMIN E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME**

##### **Neni 18**

##### **Leja për vendosjen e objekteve të përkohshme**

1. Objektet e përkohshme vendosen dhe ndërtohen në bazë të Lejes për vendosje /ndërtim.

2. Leja për vendosjen e objekteve të përkohshme për pronën publike për të cilën është zhvilluar procedura e ankandit publik lëshohet nga Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit sipas kërkesës së fituesit nga ankandi publik.

3. Leja për vendosjen e objekteve të përkohëshme të cekura në nenin 8 paragrafi 1. nën paragrafët 1.10 dhe 1.12, nenin 9 paragrafi 8, neni 13 dhe 15 lëshohet nga Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

4. Përveç rasteve të përcaktuara me paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni, Leja për vendosjen e objekteve të përkohshme sipas nenit 5. paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 dhe 2.3, neneve 8, 9, 10, 11 dhe 12 lëshohet nga Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

5. Leja për vendosjen/ndërtimin e objekteve të lartëcekura lëshohet me Vendim dhe përmban të dhënat për: shfrytëzuesin, lokacionin, sipërfaqen që mbulon, llojin dhe destinimin e objektit, sipërfaqen e objektit, afatin e shfrytëzimit, obligimet e shfrytëzuesit në rregullimin e hapësirës dhe kyqjen në objektet e infrastrukturës komunale.

### **Neni 19**

#### **Kërkesa për lëshimin e lejes për vendosjen e objektit të përkohshëm**

1. Me kërkesen për lëshimin e Lejes për vendosje të objektit të përkohshëm në pronën publike për të cilat është zhvilluar procedura e ankandit publik, shfrytëzuesi është i obliguar që të dorëzojë dokumentacionin si në vijim:

- 1.1. Dëshminë mbi të drejtën e shfrytëzimit të tokës përkatësisht kontratën për shfrytëzimin e tokës;
- 1.2. Çertifikatën e regjistrimit të biznesit;
- 1.3. Prezentimin grafik të lokacionit;
- 1.4. Projektin ideor;
- 1.5. Dëshmi mbi pagesën e qirasë (fatura) për shfrytëzimin e tokës për vendosjen e objektit të përkohshëm;
- 1.6. Dëshminë e regjistrimit në regjistrin e shërbimeve të konsumatorëve për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave.

2. Për vendosjen e objekteve të përkohëshme për të cilat nuk zhvillohet procedura e ankandit publik, parashtruesi i kërkesës bashkangjet dokumentacionin si në vijim:

- 2.1. Formularin e plotësuar me të dhënat e kërkuara nga drejtorati përkatës;
- 2.2. Kopja e letërnjoftimit për personat fizik;
- 2.3. Certifikata e regjistrimit të biznesit për personat juridik;
- 2.4. Projekti ideor;
- 2.5. Vërtetimi nga komuna për përmbushjen e obligimeve të tatimit në pronë;
- 2.6. Atestet për pajisjet për të cilat konsiderohet e nevojshme (pajisjet për lojëra fëmijësh).

3. Për subjektet e biznesit që zhvillojnë veprimtarinë në hapësirën e njëjtë nga viti i kaluar dhe është subjekti i njëjtë nuk kërkohet projekti ideor sipas paragrafit 2 nënparagrafi 2.4 të këtij neni pasi që është e verifikuar vitin paraprak, përveç nëse ka ndryshime nga subjekti apo hapësira e kërkuar.

## **Neni 20**

### **Afati për lëshimin e lejes dhe vlefshmëria e saj**

1. Leja për vendosje/ndërtimin e objektit të përkohshëm lëshohet në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara me këtë Rregullore dhe Planin.
2. Leja e humb vlefshmërinë e saj nëse vendosja /ndërtimi i objektit të përkohshëm nuk fillon ose nuk përfundon në afatin e përcaktuar në Leje.
3. Shfrytëzuesi i tokës është i obliguar që objektin ta vë në funksion në afat prej 60 ditësh nga dita e lëshimit të Lejes.
4. Nëse në afatin e përcaktuar shfrytëzuesi nuk e vë në funksion objektin e përkohshëm leja për ndërtim e humb vlefshmërinë e saj.
5. Leja për ndërtim mund të vazhdohet me kusht që shfrytëzuesi të dorëzojë kërkesën për vazhdimin e afatit para skadimit të afatit të vlefshmërisë së lejes për ndërtim.

## **Neni 21**

### **Tërheqja e lejes**

1. Leja për vendosjen e objektit të përkohshëm mund të tërhiqet para kalimit të afatit të caktuar, nëse:
  - 1.1. Paraqitet nevoja për realizimin e planit urbanistik, të programit të rregullimit, apo për shkak të pengimit të trafikut të këmbësorëve;
  - 1.2. Ka kaluar afati i caktuar për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës publike;
  - 1.3. Nuk kryhet pagesa për shfrytëzimin e pronës publike;
  - 1.4. Objekti tjetërsohet te personi i tretë, në bazë të faljes, shitjes, ndërrimit apo dhënies me qira.

## **Neni 22**

### **Lëshimi i lejes për përdorim**

1. Objekti i përkohshëm për të cilin është dhënë leja për vendosje apo ndërtim nuk mund të shfrytëzohet pa Lejen e përdorimit. Lejen për përdorim e lëshon organi i cili ka lëshuar lejen e ndërtimit apo vendosjes.
2. Organi i Administratës – Drejtorati për Planifikim dhe Urbanizëm i cili e ka dhënë lejen për vendosje/ndërtim të objektit të përkohshëm ka për detyrë ta japë lejen për përdorim brenda 15 ditëve nga dita parashtrimit të kërkesës për leje përdorimi.
3. Organi nga paragrafi 1 i këtij neni mund të refuzojë dhënien e lejes për përdorim, nëse investuesi nuk i ka plotësuar kushtet që janë përcaktuar në lejen për vendosje/ndërtim të objektit.
4. Objekti i përkohshëm është i përshtatshëm për përdorim nëse:
  - 4.1. Përdoret për destinimin e paraparë;
  - 4.2. Nuk rrezikon jetën dhe shëndetin e njerëzve;
  - 4.3. Nuk rrezikon dhe nuk pengon shfrytëzimin e objekteve në afërsi;
  - 4.4. Janë plotësuar kushtet për sigurim nga zjarri, mos pengim të trafikut, si dhe kushtet për

mbrojtje në punë;

4.5. Objekti është ndërtuar sipas kushteve të parapara, në bazë të të cilit është dhënë leja;

4.6. Janë plotësuar kushtet e veçanta, të përcaktuara me dispozitat për mbrojtjen e mjedisit.

5. Ankesa kundër vendimit nga paragrafi 1. i këtij neni, nuk ndalon zbatimin e vendimit.

### **Neni 23**

#### **Largimi i objekteve të përkohshme**

1. Objektet e përkohshme mund të largohen për arsye si në vijim:

1.1. Nëse shfrytëzuesi - pronari i objektit të përkohshëm ndryshon llojin e destinimit të objektit pa lejen e organit komunal i cili ka lëshuar lejen e ndërtimit;

1.2. Nëse objekti i përkohshëm vendoset pa leje të organit kompetent komunal për lëshimin e Lejes për vendosjen/ndërtim konsiderohet objekt i përkohshëm pa leje;

1.3. Largimi i objekteve të përkohshme nga prona publike bëhet me rastin e implementimit të planeve urbane komunale, ndryshimit dhe plotësimit të tyre, ndryshimit dhe plotësimit të planeve për vendosjen e objekteve të përkohshme, pas akteve tjera që i nxjerr komuna për realizimin e interesit publik dhe objekteve që bien në kundërshtim me planin për vendosjen e objekteve të përkohshme.

2. Pronari i objektit të përkohshëm është i obliguar që ta largojë me shpenzime të vetat objektin e përkohshëm në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e skadimit të afatit të miratimit, kushteve të përcaktuara në pikën c të paragrafit paraparak pa të drejtën e kompenzimit të vlerës së objektit dhe pa të drejtën e sigurimit të lokacionit tjetër.

3. Nëse pronari i objektit nuk vepron sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni largimi i objektit të përkohshëm do të zbatohet nga Oorgani kompetent – inspektorati komunal dhe në rast të veprimeve të ndërmarra për largimin e objektit të përkohshëm komuna nuk mban përgjegjësi për dëmtimet e objektit ose paisjeve dhe mallërave të cilat gjinden në të.

### **Neni 24**

#### **Rezervimi i të drejtave të Komunës për largimin e përkohshëm të objekteve lëvizëse**

1. Me rastin e dhënies në shfrytëzim të tokës për nevojat e vendosjes së terasave para objekteve hoteliere dhe objekteve tjera lëvizëse, Komuna e Lipjanit ruan të drejtën që në kohën e manifestimeve kulturore, turistike, argëtime etj për të cilat është organizatore të urdhëroj shfrytëzuesin që përkohësisht ose plotësisht të largojë terasën para objektit hotelier.

2. Urdhërin për largim të përkohshëm të terasave dhe objekteve tjera lëvizëse e nxjerr Inspektorati komunal sipas kërkesës së organit kompetent komunal për kulturë, sipas të cilit definohet afati dhe kushtet tjera për largimin e terasave.

## **VI. OBLIGIMET E SHFRYTËZUESVE TË PRONËS PUBLIKE**

### **Neni 25**

#### **Obligimet e shfrytëzuesëve të pronës publike**

1. Shfrytëzuesi i objektit të përkohshëm është i obliguar që të mirëmbajë objektin dhe hapësirën shfrytëzuese për rreth në gjendje teknike, estetike dhe funksionale.

2. Nëse shfrytëzuesi i objektit të përkohshëm nuk vepron sipas paragrafit 1. të këtij neni Inspektorati komunal, me vendim të veçantë, urdhëron shfrytëzuesin e objektit për eliminimin e të metave të konstatuara.

## **VII. ZBATIMI I RREGULLORES**

### **Neni 26**

#### **Zbatimi i Rregullores**

Përgjegjës për zbatimin e kësaj rregulloreje është Drejtorati për Planifikim dhe Urbanizëm, Drejtorati për Shërbime Publike, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, Zyra e Kryetarit – Sektori pronëso-ro-juridik dhe Drejtorati për Inspeksion.

## **VIII. DISPOZITAT NDËSHKIMORE**

### **Neni 27**

#### **Dispozitat ndëshkimore**

Drejtorati për Inspektorat, me vendim urdhëron heqjen, largimin apo demolimin e objektit me shpenzimet e pronarit të objektit, dhe do të gjobitet me gjobë konfrom dispozitave të Ligjit mbi Kundërvajtje nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

## **IX. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

### **Neni 28**

#### **Vlefshmëria e lejeve ekzistuese**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfrytëzuesit e objekteve të përkohshme mbajnë të drejtën e shfrytëzimit të pronës komunale deri në ditën e kalimit të afatit të caktuar në aktin mbi të drejtën e shfrytëzimit.

2. Nëse pronat e caktuara sipas paragrafit 1. të këtij neni janë përfshirë në kuadër të Planit për vendosjen e objekteve të përkohshme, mëherë pas përfundimit të periudhës së shfrytëzimit trajtohen sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

### **Neni 29**

#### **Miratimi i planit**

Plani për vendosjen e objekteve të përkohshme duhet të miratohet nga Kuvendi i Komunës, në afat prej 120 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

### **Neni 30**

#### **Hyra në fuqi**

1. Kjo Rregullore hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare elektronike të Komunës.

2. Për çdo çështje që nuk është rregulluar me dispozitat e kësaj Rregulloreje, zbatohen dispozitat e ligjeve në fuqi që rregullojnë dhënien e pronave publike në shfrytëzim.

3. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme të Pronës Publike 15Nr.011-5823 e dates 01.02.2016

### Propozim

Baza juridike për të propozuar miratimin e Rregullore është e paraparë me dispozitat e nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dhe nenit 40 pika h) të Statutit të Komunës së Lipjanit INr.110-623 të datës 26.09.2008.

Baza juridike për të miratuar këtë Rregullore është e përcaktuar me dispozitat e neneve 12 par. 12.2 pika c, 14 par. 14.1 dhe nenit 40 par. 40.2 pika a) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 9 dhe 20 par. 1 të Statutit të Komunës së Lipjanit INr. 110-623 i datës 26.09.2008.

Në kapitullin I të rregullore propozohen dispozitat e përgjithshme.

Në kapitullin II të rregullore propozohen ligjet e objekteve të përkohëshme.

Në kapitullin III propozohet dhënia e tokës në shfrytëzim në të cilën vendosen objektet e përkohshme.

Në kapitullin IV propozohet të hartohet plani për vendosjen e objekteve të përkohshme.

Në kapitullin V parashihen kushtet dhe procedurat për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme.

Në kapitullin VI përcaktohen obligimet e shfrytëzuesve të pronës publike.

Në kapitullin VII parashihet zbatimi i rregullore.

Në kapitullin VIII përcaktohen dispozitat ndërkohore.

Në kapitullin IX parashihen dispozitat kalimtare dhe të fundit.

Në pajtim me dispozitat e cekura ligjore, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e kësaj Propozim - Rregulloreje.

INr. 011/01-48388  
Lipjan, më 07.09.2022

